



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

LISTË VERIFIKIMI PËR INSEKTIMIN E ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR (ZVAP), PËR MASAT E MARRA PËR ARSIMIN E FËMIJËVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR INSEKTIMIN E ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ZVAP), PËR
MASAT E MARRA PËR ARSIMIN E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Drejtori i ZVAP:

Lloji Aktivitetit:

BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, për "Kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar".
- Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune

si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

- Urdhër nr.454, datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nënpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”.

- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar me nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Pika 3, Neni 64, Ligji 69/2012 si dhe pika 1, neni 80 Urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka ngritur ZVAP-ja Komisionin Multidisiplinar për nxënësit me AK, i përbërë nga 1 mjekë, 1 psikolog, 1 mësues dhe drejtuesi i NjShPS-së?		
2	Pika 2, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka ngritur ZVAP-ja më shumë se një komision, në bazë të numrit të IA-ve që mbulon dhe në bazë të numrit të nxënësve me AK, për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim?		
3	Pika 6, kreu I, Udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019.	A ka vlerësuar Komisioni Multidisiplinar shkallën e vështirësive të çdo nxënësi, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga prindi/kujdestari ligjor apo nga institucioni arsimor?		
4	Germa a, pika 6, kreu I, Udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019.	A ka përcaktuar Komisioni Multidisiplinar : a) nevojat arsimore të nxënësit?		
5	Germa b, pika 6, kreu I, Udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019.	A ka përcaktuar Komisioni Multidisiplinar : b) nevojën për mësues ndihmës në klasë?		
6	Germa c, pika 6, kreu I, Udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019.	A ka përcaktuar Komisioni Multidisiplinar : c) nevojën për mësues ndihmës në shtëpi?		
7	Germa ç, pika 6, kreu I, Udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019.	A ka përcaktuar Komisioni Multidisiplinar : ç) numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënës me AK dhe shënuar atë në dosjen e vlerësimit?		
8	Germa d, pika 6, kreu I, Udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019.	A ka bërë Komisioni Multidisiplinar : d) rivlerësimin e nevojës së nxënësit për mësues ndihmës, pas çdo vlerësimi (një herë në vit)?		
9	Germa a, pika 7, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka njoftuar Komisioni Multidisiplinar personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
10	Germa b, pika 7, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A i ka dhënë me shkrim Komisioni Multidisiplinar personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme dhe anasjelltas?		
11	Germa c, pika 7, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020	A ka rekomanduar Komisioni Multidisiplinar shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese?		
12	Germa ç, pika 7, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka rekomanduar Komisioni Multidisiplinar pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, kur fëmija nuk e ka?		
13	Pika 9, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka ftuar Komisioni Multidisiplinar të paktën njërin prind (ose kur nuk është e mundur një të afërm) gjatë vlerësimit të fëmijës, si dhe kur fëmija është në kopsht/shkollë edhe punonjësin e shërbimit psiko-social të IA-së dhe mësuesin e fëmijës të caktuar nga drejtori i IA-së?		
14	Pika 10, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka rekomanduar Komisioni Multidisiplinar ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur ka gjykuar se, ndjekja e shkollës së zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me AK?		
15	Pika 11, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka njoftuar me shkrim Komisioni Multidisiplinar drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor, se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programet lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale?		
16	Pika 11, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka njoftuar me shkrim Komisioni Multidisiplinar drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor mjetet ndihmëse që i nevojiten fëmijës për të realizuar procesin mësimor-edukativ?		
17	Pika 12, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A i ka udhëzuar Komisioni Multidisiplinar komisionet e IA-ve për punën me nxënësit me AK?		
18	Pika 13, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A disponon Komisioni Multidisiplinar dokumentacionin fillestar të fëmijës me AK, të cilin e përditëson me ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin e IA-së?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
19	Pika 14, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020	A ka siguruar ZVAP kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së Komisionit Multidisiplinar?		
20	Pika 15, neni 80, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A i ka vënë ZVAP në dispozicion Komisionit Multidisiplinar dokumentacionin e fëmijëve që do të vlerësojë, të paktën dy javë para vlerësimit?		
21	Pika 3, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është njoftuar për një vend të lirë pune, kandidati i profilit arsim special nga KVD e DRAP në varësi të të cilit ZVAP është, përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online?		
22	Pika 3/1, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është paraqitur kandidati në ZVAP-in përkatës në prani të Komisionit Ad-Hoc, sipas njoftimit të KVD-së? A përbëhet komisioni Ad-Hoc nga drejtuesi i ZVAP dhe dy anëtarë?		
23	Pika 4, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A i është dhënë e drejta e zgjedhjes për vendin e lirë të punës kandidatit të profilit arsim special që në renditjen e përgjithshme ka numrin më të madh të pikëve?		
24	Pika 4, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A ka mbetur në listën e pritjes me të njëjtat pikë për një periudhë deri në dy vite, kandidati i cili nuk është paraqitur në thirrjen e organizuar dhe njoftuar përmes postës elektronike nga DRAP ose e ka refuzuar vendin e lirë të punës ?		
25	Pika 5, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është përzgjedhur kandidati i profilit arsim special i kategorisë së personave me aftësi të kufizuara (AK), kur dy kandidatë rezultojnë me pikë të barabarta dhe në rast se nuk ka patur persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i është ofruar kandidatit që ka pasur rezultatin më të lartë në testim?		
26	Pika 5, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është përzgjedhur me short kandidati i profilit arsim special, midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta ?		
27	Pika 6, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është pajisur nga ZVAP-i kandidati me dokumentin vërtetues për pozicionin e pranuar dhe a është paraqitur pranë institucionit arsimor parauniversitar për të lidhur kontratën?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
28	Pika 7, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është hequr nga lista e portalit “Mësues për Shqipërinë” kandidati që ka përzgjedhur vendin e punës dhe është punësuar nga institucioni arsimor?		
29	Pika 8, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar	A është punësuar kandidati fitues nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale, me afat të pacaktuar, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga komisioni për vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë dhe punonjësve të tjerë në institucionet arsimore parauniversitare?		
30	Pika 9, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është dokumentuar nga ZVAP procesi i përzgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat dhe a është raportuar me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në AKAP dhe MAS emërimi/refuzimi apo moskonfirmimi i kandidatëve ?		
31	Pika 9, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A ka njoftuar KVD e DRAP-it për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve, të cilët në aplikim kanë zgjedhur edhe opsionin “arsim special” duke respektuar renditjen, në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës?		
32	Pika 9, kreu IV, të Udhëzimi nr. 8, datë 03.05.2024, i ndryshuar.	A është bërë punësimi i kandidatëve që kanë zgjedhur opsionin “arsim special” me kontratë pune me afat deri në përfundim të vitit shkollor me të drejtë rinovimi të saj deri në emërimin e një kandidati nga portali të profilit “Arsim special”?		
33	Pika 2, neni 81, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka caktuar ZVAP mësuesin ndihmës për fëmijët me AK, sipas nevojave individuale të tyre, bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar?		
34	Germa a, pika 1, kreu I, të Udhëzimit Nr.26, datë 25.11.2019	A zotërojnë mësuesit ndihmës për nxënësit me AK licencë në profilin “Arsim special”?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
35	Germa b, pika 1, kreu I, të Udhëzimit Nr.26, datë 25.11.2019.	A zotërojnë mësuesit ndihmës për nxënësit me AK diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit (sipas përcaktimeve të ligjit 69, neni 57, pika 2, 3 dhe 4) si dhe trajnime për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe certifikatë/dëshmi/diplomë që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar?		
36	Pika 3, neni 81, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka informuar ZVAP IA-të publike për shërbimet rehabilituese që ofrohen nga institucionet shtetërore shëndetësore?		
37	Pika 4, neni 81, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A ka pajisur ZVAP me përparësi nxënësit me AK me mjete mësimore dhe pajisje ndihmëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin e tyre personal e ndërpersonal?		
38	Pika 5, neni 81, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020	A ka organizuar ZVAP, nëpërmjet NjShPS, bashkëpunimin e mësuesve të shkollave të specializuara, me mësuesit e shkollave të zakonshme, për hartimin dhe vënien në jetë të planeve edukative (PEI) për nxënësit me AK?		
39	Germa f, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019, dhe pika 1, neni 14, kreu III, të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019.	A propozon grupi i inspektimit për masë disiplinore ndaj personave përgjegjës në ZVAP për shkeljet e konstatuara?		
40	Germa b, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.	A jep grupi i inspektimit rekomandimet përkatëse për shkeljet e konstatuara?		

INSPEKTORËT